
KONFERENCË NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM RAJONAL

24-25 MARS 2022
PRISHTINË “Hotel Emerald”



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Ministria e Zhvillimit Rajonal në Republikën e Kosovës është duke organizuar konferencën ndërkombëtare me titull: “Sfidat dhe perspektiva e zhvillimit rajonal në Ballkanin Perëndimor”.

Konferenca është e para e këtij formati, ku synim kryesor ka forcimin e komunikimit, rritjen e bashkëpunimit mes vendeve të rajonit (Ballkanit Perëndimor) dhe vendeve të BE-së, përmes ndarjes së informacionit, përvojave dhe ideve në politikat/legjislacionin, praktikave në këtë fushë. Njohja me strukturën e organizimit të rajoneve, mekanizmave zbatues, dhe programeve që i kontribuojnë zhvillimit rajonal.

Njëkohësisht, mundësia e njohjes dhe adaptimit të programeve të zbatuara në këtë fushë në shtetet tjera, në veçanti të Evropës perëndimore si mundësi për zgjerimin e mundësive dhe potencialit për përafrim me politikat evropiane dhe qasjen në fondet në këto fusha. Konferenca synohet të kthehet në nismë të përbashkët rajonale, ku vendet përcaktojnë agjendën e ngjarjeve dhe çështjeve për diskutime të rregullta vjetore.

SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMIT RAJONAL NË BALLKANIN PERËNDIMOR

QËLLIMI

Konferenca Ndërkombëtare për Zhvillim Rajonal ka për qëllim të identifikojë sfidat kyçe, t'i koordinojë përpjekjet e përbashkëta dhe zgjerojë mundësitë e zhvillimit ekonomik të vendeve të rajonit.

PJESËMARRJA

Në këtë Konferencë parashihet të marrin pjesë - vendet e rajonit dhe disa vende të BE-së:

- Shqipëria;
- Maqedonia Veriore;
- Turqia;
- Mali i zi;
- Gjermania;
- Polonia;
- Sllovenia;
- Kroacia;
- Serbia;
- Bosna dhe Hercegovina;
- Bullgaria.

Vende këto me përvojë të avancuar në fushën e zhvillimit rajonal dhe qasjes në fondet e BE-së në këtë fushë. Në konferencë do të ftohen: Zyra e BE-së në Kosovë dhe organizata tjera që i kontribuojnë zhvillimit rajonal.

PËRMBAJTJA

Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e Planit të Punës për vitin 2022, ka paraparë organizimin e Konferencës Ndërkombëtare për Zhvillim Rajonal, aktivitet me pjesëmarrje të vendeve të rajonit dhe disa vendeve të BE-së.

Konferenca do t'i bëjë bashkë, politik-bërësit, vendimmarrësit, organizatat kontribuese dhe donatorët nga vendet e rajonit në një tryezë të përbashkët, në një diskutimin të çështjeve që prekin fushat e zhvillimit ekonomik rajonal, si dhe gjetjen e mundësive për rritjen e komunikimit dhe bashkëpunimit në të ardhmen. Pjesëmarrësit në konferencë do të kenë mundësinë të njihen dhe shkëmbejnë përvojat e zhvillimit rajonal të vendeve të tyre, si dhe të diskutojnë tema me interes për Zhvillimin Socio-Ekonomik Rajonal.

Përfaqësues nga vendet e ftuara do të prezantojnë nga perspektiva dhe konteksti, praktikat të organizimit dhe funksionimit të procesit të zhvillimit rajonal. Në konferencën Ndërkombëtare për Zhvillim Rajonal, do të marrin pjesë dhe prezantojnë përfaqësues nga autoritetet qendrore dhe lokale, përfaqësues nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Kjo Konferencë, do të fokusohet edhe në adaptimin e përvojave të reja rajonale dhe aplikimin e tyre në zhvillimin e konsensusit në mes të akterëve, të cilët merren me zhvillim ekonomik rajonal si dhe shkëmbimi i përvojave me vende anëtare të BE-së si: Gjermania, Bullgaria, Sllovenia, Kroacia dhe Polonia.

Procesi i avancimit të zhvillimit rajonal vazhdon të mbetet njëra ndër çështjet me interes të veçantë për vendet e rajonit, si mundësi e bashkëpunimit në zhvillim ekonomik dhe përafrim në proceset integruese në Bashkimin Evropian. Bazuar në objektivat e legjislacionit të ri dhe modern për zhvillim rajonal, Kosova dhe rajoni është duke kaluar në një fazë të rëndësishme të organizimit të zhvillimit ekonomik rajonal, që ka nevojë për avancime të mëtutjeshme për të arritur synimet e përcaktuara.

ÇËSHJET KYÇE TË INTERESIT TË PËRBASHKËT

- Në kuadrin e Konferencës Ndërkombëtare për Zhvillim Rajonal, do të identifikohen fushat e bashkëpunimit dhe do të ndërtohet agjenda për bashkëpunim në iniciativa, programe dhe projekte të përbashkëta;
- Konferenca do të promovojë një mekanizëm lehtësues për zbatimin e programeve dhe projekteve nga vendet përkatëse që kanë shënuar rezultate, duke reduktuar kohën për ndarjen e përvojave dhe praktikave si dhe duke shumëfishuar efektet e financimeve nga donatorët;
- Një dimension tjetër ka të bëjë me shkëmbimin e përvojave, kapaciteteve për programet/projektet për rritjen e mundësive të qasjes në fondet strukturore dhe kohezive të Bashkimit Evropian.

PËRFAQËSIMI NË KONFERENCË I SHTETEVE PJESËMARRËSE

Në kuadër të kësaj konference do të prezantohen temat lidhur me përvojat në sferën e zhvillimit Rajonal, si dhe përfaqësimi do të jetë në dy nivele:

- Niveli politik – ku do të ftohen të marrin pjesë Ministrat përkatës që mbulojnë fushën e zhvillimit rajonal nga shtetet pjesëmarrëse. Të njejtë do të mbajnë nga një fjalë rasti.
- Niveli Institucional – ku do të marrin pjesë të deleguarit/ përfaqësuesit që do të mbajnë prezantim i cili duhet të ndërlihet kryesisht me temat si vijon:

Zhvillimi i politikave për zhvillim rajonal të balancuar: *dokumentet strategjike dhe planifikuese të zhvillimit rajonal me qëllim të intervenimeve në fusha të caktuara për arritjen e zhvillimit të balancuar rajonal.*

Zhvillimi i Programeve për zhvillim rajonal: *programet që përcaktojnë drejtimit prioritare të zhvillimit rajonal në kuadër të rajoneve zhvillimore.*

Shfrytëzimi i fondeve të BE-së për zhvillim rajonal: *qasja në fondet strukturore dhe kohezive të BE-së.*

Kriteret për zhvillim rajonal të balancuar: *kriteret e përcaktuara për matjen e pabarazive rajonale dhe performancës rajonale.*

Organizmi dhe funksionimi i Agjencive për Zhvillim Rajonal: *strukturat e zhvillimit rajonal sipas vendeve pjesëmarrëse.*

Prezantimi i koordinimit të procesit institucional dhe koordinimit të politikave për zhvillim rajonal: *hierarkia koordinuese e zhvillimit rajonal në vende të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të BE-së.*

Në kuadër të kësaj konference do të prezantohen temat lidhur me përvojat në sferën e zhvillimit rajonal të shteteve pjesëmarrëse.

Konferenca parasheh që ministrat e shteteve pjesëmarrëse të mbajnë një fjalë rasti ditën e hapjes, si dhe mirësisht kërkohet nga ana juaj të përcaktoni përfaqësuesit, të deleguarit institucional që do ti kontribuojnë Konferencës me prezantimet e tyre sipas fushës respektive të lartcekur.

Ju lutemi të na konfirmoni gatishmërinë tuaj për pjesëmarrje si dhe të na dërgoni detajet e kontakteve për përfaqësuesit e tjerë në këtë e-mail: Vjendita.AvdIU@rks-gov.net; apo në numrin kontaktues: +383(38) 200 64 516 apo e-mailin: melis.shamli@rks-gov.net apo në numrin kontaktues +382(38) 200 64 551.

Përshkak të masave Anti-Covid numri i pjesëmarrësve është i limituar deri në katër (4) persona për vendin pjesëmarrës.

Për çdo informacion shtesë mos hezitoni të na kontaktoni!

Faleminderit!